



PARIMET E PËRBASHKËTA TË FINANCIIMIT PËR MEDIAT E SHËRBIMIT PUBLIK NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Duke pranuar rëndësinë e Medieve të Shërbimit Publik (MSHP) për proceset e demokratizimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor cilat synojnë pranimin në BE;

Duke ritheksuar standardet e Këshillit të Evropës (KE), Parimet e EBU të Financimit Publik si dhe praktikat më të mira në Evropë për financimin e Medieve të Shërbimit Publik;

Duke pasur parasysh rëndësinë që MSHP të zhvillohen në përputhje me zhvillimet ekonomike, sociale dhe teknologjike si dhe nevojën për t'u përshtatur me to si dhe me qëllim që t'i sigurojë MSHP një rol vendimtar në shoqëri në të gjitha platformat;

Duke nënvizuar rëndësinë e prodhimit me përmbajtje të cilësisë së lartë si një mjet të besueshëm në luftën kundër dezinformimit si dhe investimit përkatës të domosdoshëm në MSHP, në veçanti në prodhimin e lajmeve;

Duke mbështetur rolin e rëndësishëm që MSHP luan si një kontribues kryesor në prodhimin e përmbajtjes me cilësi të lartë të karakterit lokal, kombëtar dhe Evropian si dhe rolin në konsolidimin e shoqërisë dhe mbështetjen e kohezionit social, duke përfshirë edhe mbulimin e ngjarjeve kryesore sportive dhe kulturore me rëndësi kombëtare;

Duke nënvizuar rëndësinë e financimit të qëndrueshëm, të pavarur, të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të MSHP, i cili mundëson përmbushjen e misionit të shërbimit publik të transmetimit; Duke pasur parasysh rëndësinë që MSHP ka për zhvillimin kombëtar të industrisë krijuese dhe talenteve;

Duke nënvizuar rëndësinë e investimit në inovacion në të gjitha aspektet e punës së MSHP si një forcë lëvizëse e industrisë së medias;

Duke pasur parasysh që rëndësia e MSHP pranohet rregullisht nga BE si një pjesë integrale e zhvillimit dhe lirive të medias në Kapitujt 23/24 dhe Kapitullin 10 të Raporteve të Progresit të KE-së në kuadër të kornizës së negociatave për avansimin e vendeve në procesin për anëtarësim drejt BE-së; Përfaqësuesit e parlamenteve, autoriteteve rregullatore, sektorit civil dhe MSHP në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mali të Zi dhe Serbi kanë rënë dakord mbi parimet e mëposhtme të përbashkëta për financimin e Medieve të Shërbimit Publik në Ballkanin Perëndimor:



1. Të i shërbejnë misionit publik dhe demokracisë
2. Të jenë të pavarura
3. Ligjërish të themeluara
4. Mbështetur politikisht
5. Të qëndrueshme dhe të ndershme
6. Të orientuara drejt së ardhmes
7. Të përgjegjshme
8. Llogaridhëse
9. Diskutimet Publike

- Të i shërbejnë misionit publik dhe demokracisë

Media e Shërbimit Publik është esenciale për procesin e demokratizimit në vendet e pranimit në BE dhe financimi i saj duhet të konsiderohet si një investim në shoqëri dhe demokraci.

Investimi në Mediet e Shërbimit Publik me cilësi të lartë, të pavarur dhe të besueshëm, duhet të shihet si një investim në zhvillimin e një kulture demokratike, të dialogut, njohurisë dhe shoqërisë.

Të jenë të pavarura-jo të varura nga favorët politike, duke promovuar kështu besueshmërinë në MSHP dhe rolin që ka si një shërbim vërtet i domosdoshëm për shoqëri;

Vetëm financimi i pavarur, i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm do të mundësojë që të kuptohet roli i rëndësishëm që ka MSHP në shoqëri për informimin, dialogun, edukimin, argëtimin dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me qytetarët.

Financimi i pavarur i Shërbimit Publik Media është një parakusht kryesor për pavarësinë institucionale dhe editoriale të MSHP.

Ligjërish të themeluara

Korniza Ligjore që rregullon MSHP duhet të siguroj mekanizmat efikase, praktike, të realizueshme dhe të zbatueshme në praktikë për financimin e MSHP.

Korniza ligjore përkatëse të MSHP duhet të siguroj mekanizma të mjaftueshme mbrojtëse për financimin të tyre, pa ndërhyrje apo presion politik.

Kur nuk është ende e mundur të futet tarifa e licencës dhe në vend të kësaj shfrytëzohet financimi nga buxheti i shtetit, duhet të inkorporohen mekanizma mbrojtës të fuqishëm për të shmangur ndërhyrjet politike, duke përfshirë financimin fiks për periudhë të gjatë (p.sh. 5 vjet), një garanci për një përqindje fikse të të ardhurave për kokë banori (GDP) dhe përshtatjeve automatike të inflacionit, duke shmangur mbështetjen e drejtpërdrejtë në diskrecion të qeverisë në pajtim me ndonjë marrëveshje specifike apo tjetër.



Ndryshimet në dispozitat ligjore për financimin e MSHP duhet të kryhen vetëm pas një vlerësimi dhe analize të përshtatshme nga një organ i pavarur dhe pas konsultimit të gjerë publik me të gjithë akterët relevant, përfshirë MSHP dhe shoqërinë civile.

Strategjitë shtetërore për mediet të cilat janë zhvilluar nga qeveritë dhe parlamentet në një dialog me të gjithë akterët kryesorë të mediave, duhet të kenë parasysh rëndësinë e Medieve të Shërbimit Publik dhe financimin e tyre të pavarur, të qëndrueshëm, të përshtatshëm dhe të parashikueshëm.

Mbështetja politike

Politikanët dhe publiku në përgjithësi inkurajohen të vlerësojnë rregullisht zbatimin e duhur të dispozitave ligjore përkatëse në lidhje me financimin e MSHP.

Politikanët dhe figurat publike në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përmbahen nga avokimi për heqjen e tarifave të licencës për MSHP dhe nga shfrytëzimi i kësaj si një mjet për të fituar vota në fushatat politike. Financimi i pavarur është thelbësor për krijimin e një MSHP të pavarur dhe të besueshëm si një faktor kryesor në demokratizimin e shoqërive.

E qëndrueshme dhe e ndershme

Financimi i tarifës së licencës është mekanizmi i preferuar për financimin e MSHP, i cili siguron një lidhje të drejtpërdrejtë dhe mishërim me audiencën.

Diskutimet mbi financimin e MSHP duhet të bëhen vetëm në lidhje me misionin që ka MSHP në shoqëri dhe me strategjinë afatmesmetë miratuar të MSHP-së.

E orientuar drejt së ardhmes

Financimi i MSHP duhet të sigurojë investime në teknologji të re, dixhitalizim dhe inovacion dhe duhet të rrisë kapacitetin e MSHP për të qenë forca lëvizëse e industrisë së medias në vendet përkatëse.

Llogaridhënës

Financimi i MSHP duhet të sigurojë shkallën më të lartë të transparencës dhe llogaridhënies përmes angazhimit të rregullt të auditimeve të brendshme dhe të jashtme dhe publikimit të planeve dhe raporteve financiare.

I përgjegjshëm

MSHP duhet të zbatojë dhe demonstrojë efikasitetin përkatës dhe të ketë një qasje të ndjeshme ndaj kostos kur zhvillon strategjitë dhe planet e prodhimit të programit.


Empowering
society

Technical Assistance to
Public Service Media
in the Western Balkans



Funded by the European Union

MSHP duhet të zbatojë mekanizma të rregullt të përgjegjësisë në mënyrë që të sigurojnë që Menaxhmenti i lartë dhe Bordi i MSHP të jenë përgjegjëse për vendimet për çështjet financiare.

Diskutimet Publike

MSHP duhet të raportojë dhe të organizojë diskutime të rregullta me qytetarët për të shpjeguar zbatimin e obligimeve dhe misionit që ka dhe kornizën përkatëse financiare të nevojshme.

Parakushtet për planet e qëndrueshme të biznesit dhe nevojave financiare /kostove të MSHP duhet të vendosen në një Strategji koherente (vizioni, misioni, përcaktimi i shkurtër dhe afatmesëm i përmbajtjes dhe strategjive funksionale, programi dhe standardet e prodhimit dhe normativa) në mënyrë transparente /publike të dakorduara dhe menjëherë të verifikueshme.

Parimet kanë për qëllim krijimin e një kornize të pavarur, të qëndrueshme, të përshtatshme dhe të parashikueshme të financimit për cilësinë dhe funksionimin e ardhshëm të Medieve të Shërbimit Publik në Ballkanin Perëndimor dhe për të mbështetur përpjekjet e shteteve për harmonizimin me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira si dhe mbështetjen për anëtarësimin në BE.

Progresi në zbatimin e këtyre parimeve do të matet dhe vlerësohet çdo vit.

Shënim: Parimet e mësipërme të përbashkëta të financimit për MSHP në Ballkanin Perëndimor u dakorduan dhe u miratuan nga të gjithë akterët kryesorë që përfaqësojnë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në takimin rajonal për "Financimin e MSHP" të mbajtur në Sarajevë më 28 maj 2019. Pjesëmarrësit gjithashtu shprehën do të ndjekin zbatimin e parimeve të sipërpërmendura me qëllim të pranimit në BE deri në vitin 2025.



OPERATING EUROVISION AND EURORADIO

